



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1 Mars 2023

Nr: 82

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË BERAT, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 1 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Berat.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 1 Mars 2023

Nr: 82
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike”

“Takim me banorët e lagjes Uznovë, në rajonin 3, për asfaltimin e lagjeve dhe problematikat e zones”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=734539441561571&set=pcb.734540224894826>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 27.2.2023, bashkisë Berat i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 28.2.2023, ora 12:39 PM, bashkia Berat bën me dije se: “...Veprimtaria Publike për të cilën bëni me dije sipas linkut

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=734539441561571&set=pcb.734540224894826>

takim me banorët e lagjes Uznovë, në Rajonin 3, për asfaltimin e lagjeve dhe problematikat e zonës është raportuar më datë 22.02.2023 sipas linkut:

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/22/takim-ne-rajonin-nr-1-nr-2-dhe-nr-3/>

...Sqarojmë se lagja Uznovë është lagje që ndodhet në Rajonin nr. 3 dhe veprimtaria publike, e raportuar sipas linkut me siper, ka qene inspektim në shtrimin e asfaltit që është kryer në Rajonin nr 3, pikërisht në këtë pjesë të rajonit, lagjen Uznovë.”

Nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Berat, ka raportuar kryerjen e aktivitetit objekt denoncimi më datë 22.2.2023.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Berat, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Berat.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI